

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
NR 1081 REP 106 KOL.



**KONTRATE E SHITBLERJES  
(KUOTAT E KAPITALIT THEMELTAR)**

Ne Tirane, ne zyren e noterise, ne rrugen "Ismail Qemali" P.27/1, sot me date 12/02/04, para meje noter Agim Xh.Robo paraqiten personalisht, palet kontraktuese me cilesite e meposhteme:

**SHITESIT: Luciano Sbergamo**, dl.01.01.1949, lindur dhe banues ne Itali, Civitacastellana, nr.pasaportes 020752 P.

**Besnik Hysenbelliu**, biri i Hasanit, dl.27.05.1967, banues ne Tirane, rruga "Vaso Pasha" P.18, nr.pasaportes 0821058.

**BLERESI: Irfan Hysenbelliu**, biri i Hasanit, dl.08.04.1959, banues ne Tirane, rruga "Vaso Pasha" nr.8, nr.pasaportes 1762730.

Te tre me zotesi te plote juridike e per te vepruar qe me vullnetin e tyre te lire kerkuan redaktimin e aktit noterial te shitblerjes se kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise tregtare "**EURO- TIRANA STUDIO**"sh.p.k.

Me vendim gjyqesor nr.27.656 date 26.04.2002 ne Regjistrin Tregetar, eshte regjistruar si person juridik shoqeria "**EURO- TIRANA STUDIO**"sh.p.k. Kapitali themeltar i saj eshte ne vlere 100.000 leke.

Ortake te saj jane z. Luciano Sbergamo, zoterues i 49% te kuotave te kapitalit themeltar dhe z. Besnik Hysenbelliu, zoterues i 51% te kuotave

Me vendim nr. 2 date 11.02.2004, Asambleja e jashtezakonshme e Ortakeve ka vendosur, miratimin e transferimit teresisht nepermjet shitjes se kuotave te kapitalit themeltar perkatesisht: prej 49% te Ortakut z. Luciano Sbergamo, dhe 51% te Ortakut z. Besnik Hysenbelliu tek zoti Irfan Hysenbelliu.

Mbi bazen e ketij vendimi hartohet edhe Kontrata noteriale e shitblerjes se kuotave te kapitalit themeltar ne baze te nenit 45 te Ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

**PERMBAJTJA E KONTRATES:**

**SHITESIT:**

Ortaku z. Luciano Sbergamo, i shet **BLERESIT** z. Irfan Hysenbelliu kuotat e tij prej 49% te kapitalit themeltar me nje vlere prej 49.000 leke.

Ortaku z. Besnik Hysenbelliu i shet **BLERESIT** z. Irfan Hysenbelliu kuotat e tij prej 51% te kapitalit themeltar me nje vlere prej 51.000 leke.

Palet kontraktuese deklarojne shlyerjen e vlefes se shitjes.

**BLERESI:** Z.Irfan Hysenbelliu pranon blerjen e kuotave zoteruese mbi kapitalin themeltar perkatesisht: 49% te Ortakut z.Luciano Sbergamo me nje vlere 49.000 leke dhe 51% te kuotave te Ortakut z.Besnik Hysenbelliu me vlere prej 51.000 leke.

Me nenshkrimin nga palet dhe vertetimin nga noteri te kesaj Kontrate, z.Luciano Sbergamo dhe Besnik Hysenbelliu humbasin cdo te drejte zoterimi mbi kuotat e kapitalit themeltar si dhe cilesine e Ortakeve ne shoqerine tregtare "EURO- TIRANA STUDIO" sh.p.k., duke mos patur me asnje te drejte pronesie mbi te.Ortak i Vetem dhe zoterues mbi 100% te kuotave te kapitalit themeltar te saj behet zoti Irfan Hysenbelliu.

Sa me siper kontrata e shitblerjes u redaktua ne baze te nenit 45 te Ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", nenit 39 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine". Kontrata iu lexohet paleve me ze te larte.

Per palen italiane qe nuk e njeh gjuhen shqipe, perkthimi i permbajtjes se kontrates u be nga njohesi i gjuhes italiane zoti Redi Pasko, i cili me deklaroi mua noterit se ka perkthyer besnikerisht Kontraten duke njohur pasojat ligjore te ketij veprimi. Palet kontraktuese deklarojne se e kuptojne permbajtjen e saj dhe nenshkruajne ne fund pa asnje verejtje.

Une noteri redaktova kontraten e shitblerjes ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe pasi e gjej aktin ne pajtim me ligjin, nenshkruaj dhe vertetoj rregullisht.


### PALET

#### SHITESIT

1. Besnik Hysenbelliu  
emri, mbiemri, firma

2. LUCIANO SBERGAMO  
emri, mbiemri, firma

Perktheu: Redi Pasko  
emri, mbiemri, firma



#### BLERESI

Irfan Hysenbelliu  
emri, mbiemri, firma



#### NOTER



Redi Pasko  
